

**A K T I I T H E M E L I M I T**

**I**

**SHOQERISE**

**E SHOQERISE AKSIONARE ME OFERTE PRIVATE**

**"AGORA SECURITIES" SHA**  
**("Shoqeria")**

Date 20/03/2019

#### **AKSIONERET THEMELUES TE SHOQERISE :**

1. **Z. Florian Selmanaj**, lindur ne Lushnje, Shqiperi, me date 04.07.1978, shtetas Shqiptar, banues ne Tirane, identifikuar nepermjet numrit personal H80704115U;
2. **Z. Nensi Shyti**, lindur ne Elbasan, Shqiperi, me date 18.07.1988, shtetas Shqiptar, banues ne Tirane, identifikuar nepermjet numrit personal I80718067S.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personat e mesiperme si me poshte:

#### **Neni 1. Forma ligjore e Shoqerise**

Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, ne formen e Shoqerise Aksionere, me nje nivel, veprimtaria e se ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

#### **Neni 2. Emri i Shoqerise**

Shoqeria eshte emertuar **AGORA SECURITIES SHA**.

#### **Neni 3. Selia e Shoqerise**

Shoqeria ka Seline e saj ne : Rr. "Ndre Mjeda", kompleksi Magnet, Pall. Perseu, Njesia 7/25, Tirane, Shqiperi.

#### **Neni 4. Kohezgjatja e Shoqerise dhe personaliteti juridik i saj**

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te shkurtohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Shoqeria **AGORA SECURITIES SHA** gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti regjistrimit si e tille ne Qendren Kombetare te Biznesit.

#### **Neni 5. Objekti i Shoqerise**

Shoqeria **AGORA SECURITIES SHA** zhvillon aktivitetin e saj si me poshte :

- i. Blerja dhe shitja e titujve me porosi të klientit.
- ii. Blerja dhe shitja e titujve në emër ose për llogari të vet.
- iii. Administrimi i portofolit të titujve në emër të një klienti që është pronar i portofolit.
- iv. Veprimtaria e këshillimit për investime në tituj.
- v. Dhurimi, shkëmbimi dhe dhënia hua e titujve.
- vi. Shitja me qëllim riblerje e titujve dhe/ose anasjelltas.
- vii. Si dhe cdo veprimtariqe ka te beje me permbushjen e objektit si me lart;

#### **Neni 6. Vendi i ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise**

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne Shqiperi dhe jashte saj.

#### **Neni 7. Transferimi i selise se Shoqerise**

Selia e shoqerise mund te transferohet.

#### **Neni 8. Kapitali aksionar, Aksionet dhe Aksionaret**

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te

kapitalit dhe te te ardhurave e perfiton Aksioneri i Shoqerise.

Aksionerit themelues perballon humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi, ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Banke si dhe me kapitale te derdhura nga vete Aksionaret.

Kapitali i Shoqerise eshte 6,000,000 (gjashte million) Lek, i ndare ne 6,000 (gjashte mije) aksione me vlere nominale 1,000 (nje mije) Lek, i nenshkruar, i ndare dhe i paguar nga Aksionaret ne raportin si me poshte shenuar :

1. Z. Florian Selmanaj, me 3,600 (tremije e gjashte qind) aksione, pjesmarrja ne kapital 60 (gjashtedhjetë) %, me vlere ne para prej 3,600,000 (tre milion e gjashteqind mije) Lek;
2. Z. Nensi Shyti, me 2,400 (dy mije e katerqind) aksione, pjesmarrja ne kapital 40 (dyzete) %, me vlere ne para prej 2,400,000 (dy milion e katerqind mije) Lek.

Fitimet qe do te rezultojne pas miratimit te bilancit vjetor nga Asambleja e Pergjithshme pas zbritjes se taksave do te ndahen si vijon:

- Fondi rezerve.
- Shperblimi qe i takon Aksionereve Themelues.

#### **Neni 9. Bashkepunimi i Shoqerise**

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te Shoqerise.

#### **Neni 10. Krijimi i filialeve te Shoqerise**

Veprimtaria e Shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, ne konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.

#### **Administrimi**

#### **Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme.**

#### **Neni 11. Keshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqerise**

Drejtimi i shoqerise do te realizohet nga Keshilli i Administrimit dhe Administratori. Anetaret e Keshillit te Administrimit emerohen nga Asambleja e Pergjithshme, per nje peridhe 3 vjecare dhe do te jene personat e poshte shenuar :

1. Z. Florian Selmanaj (Kryetar), lindur ne Lushnje, Shqiperi, me date 04.07.1978, shtetas Shqiptar, banues ne Tirane, identifikuar nepermjet numrit personal H80704115U
2. Z. Nensi Shyti (Anetar), lindur ne Elbasan, Shqiperi, me date 18.07.1988; shtetas Shqiptar, banues ne Tirane, identifikuar nepermjet numrit personal I80718067S;
3. Besmir Masha (Anetar), lindur ne Fushe-Kruje, Shqiperi, me 02.03.1991, shtetas Shqiptar, banues ne Tirane, identifikuar nepermjet numrit personal J10302083R.

#### **ADMINISTRATORI / ADMINISTRATORET**

Ne shoqerine AGORA SECURITIES SHA administrator i shoqerise do te jete:

Besmir Masha, lindur ne Fushe-Kruje, Shqiperi, me 02.03.1991, shtetas Shqiptar, banues ne Tirane, identifikuar nepermjet numrit personal J10302083R.

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej tre vitesh financiare. Administratori ka te gjitha kompetence per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Keshilli i Administrimit.

### **Neni 12. Mbyllja e Shoqerise**

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga Asambleja e Pergjithshme, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

### **Neni 13. Likujdimi i Shoqerise**

Asambleja e Pergjithshme emeron likujdatorin dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne Aksionereve, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.


### **Neni 14. Te pergjithshme**

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Pergjithshme. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.



Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

### **ASAMBLEJA PERGJITHSHME**



Florian Selmanaj



Nensi Shyti

